



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 44, Datë 15.03.2019

MBI

RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “AYEN ENERGY TRADING” SH.A., NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “ç” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “d”; nenit 5, pika 1 germa “d”; nenit 13 dhe nenit 16 të “Rregullores për Proçedurat dhe Afatet per dhenie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licensave ne Sektorin e Energjise Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 15.03.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ayen Enrgy Trading” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 17, datë 18.02.2019, filloi procedurën për rinovimin e licencës se shoqërisë “AYEN ENERGY TRADING” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 32/4 Prot, datë 18.02.2019, bëri njoftimi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 93/2 Prot., datë 20.02.2019, dërgoi pranë subjektit njoftimin e vendimit, dhe bëri me dije mungesën e dokumentacionit të konstatuar në aplikim.
- Rezulton se mbas përfundimit të afateve të pritjes se komenteve dhe opinionëve nuk ka komente apo sugjerime në lidhje me këtë aplikim.
- Shoqëria “Ayen Enrgy Trading” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 93/3, datë 04.03.2019, ka plotësuar dokuemntacionin e munguar.
- Aplikimi i shoqërisë “Ayen Enrgy Trading” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Proçedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:
 - **Formati i aplikimit** (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor** (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- **Dokumentacioni financiar dhe fiskal** (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- **Dokumentacioni teknik** (neni 9, pika 4.7 dhe 4.7.1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi të ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI